



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-16

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN NË LIGJIN NR. 2003/2 DHE 2003/21
PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË**

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të autoritetit të dhënë dhe përgjegjësi të bartura në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) nga Misioni i Përkohshëm i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), me Rregulloren Nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001, “Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë;”

Duke marrë parasysh kompetencat e rezervuara për PSSP me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9;

Duke marrë parasysh po ashtu Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, “Mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë”; dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/24 të datës 12 Dhjetor 1999, “Mbi ligjin e zbatueshëm në Kosovë,” të ndryshuar; dhe

Duke njohur nevojën për të ndryshuar Nenin 21 të Ligjit nr. 2003/2 dhe 2003/21, “mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë”, për t’i dhënë kohë të mjaftueshme Kuvendit për të shqyrtuar dhe aprovuar Ligjin mbi ndarjet buxhetore vjetore, me të cilin përcaktohen ndarjet buxhetore për vitin e dhënë fiskal, që pason drejtpërdrejtë zgjidhjet e përgjithshme për anëtarët e Kuvendit;

Përmes kësaj aprovon ndryshimin në Ligjin Nr. 2003/2 dhe 2003/21, të paraqitur në vijim:

**LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN NË LIGJIN NR. 2003/2 DHE 2003/21
PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË**

Neni 1

Neni ekzistues 21 i Ligjit Nr. 2003/2 dhe 2003/21, me këtë anulohet dhe zëvendësohet me Nenin e ri 21 me sa vijon:

Neni 21

Ndarjet buxhetore në mungesë të ligjit mbi ndarjet buxhetore

21.1. Nëse Ligji vjetor mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal nuk aprovohet nga Kuvendi dhe nuk shpallet nga PSSP para fillimit të vitit të dhënë fiskal, Ligji mbi ndarjet buxhetore i zbatueshëm për vitin paraprak fiskal, do të konsiderohet:

- a). Nëse zgjedhjet e përgjithshme për anëtarët e Kuvendit janë mbajtur më pak se katër (4) muaj para fillimit të atij viti fiskal:
 - (i) që është zgjatur për të mbuluar dy (2) muajt e parë të vitit të dhënë fiskal; dhe
 - (ii) që siguron ndarjen buxhetore për secilën organizatë buxhetore, që është baras me gjashtëmbëdhjetë dhe dy të tretat përqind (16.67%) të ndarjes buxhetore që sigurohen për organizatën e tillë buxhetore me Ligjin e tillë për ndarjet buxhetore; apo
- b). Nëse nuk ka pasur zgjedhje të tilla përbrenda kësaj periudhe:
 - (i) që është zgjatur për të mbuluar muajin e parë të vitit të dhënë fiskal; dhe
 - (ii) që siguron ndarjen buxhetore për secilën organizatë buxhetore, që është baras me tetë dhe një e treta përqind (8.33%) të ndarjeve buxhetore të siguruar për atë organizatë buxhetore me Ligjin e tillë për ndarjet buxhetore.

21.2. Cilado ndarje buxhetore e sanksionuar me nenin 21.1 do të pushojë të ketë fuqi apo efekt, në datën në të cilën Ligji i ri mbi ndarjet buxhetore vjetore hyn në fuqi; dhe të gjitha shpenzimet e bëra në përputhje me ndarjet buxhetore të sanksionuara me nenin 21.1 do të trajtohen si shpenzime të bëra në pajtim me ndarjet buxhetore që autorizohen me Ligjin e ri mbi ndarjet buxhetore.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hynë në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe shpalljes nga ana e PSSP-së.

**Ligji Nr. 02/L-16
23 shkurt 2005**

Kryetar i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci